



Pranimi / Dënimi / Prilog / Priloge / Prilog / Priloge		19. 01 2022		viti / god. Year	
Organizimi / Org. Unit	Ishtupja / Priloge / Priloge	Ishtupja / Prilog / Priloge	Sasia / Kolicina / Quantity		
SKPM SHK 241/2022			113		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1220/ 2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1220/2021, të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1220/2021 të datës 24.12.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me datë 24.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6332/2021 të regjistruar me numër A.nr.1220/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit dhe trajtim me koleget e tjerë në pozitën e njëjtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Ndërsa, Këshilli më datë 06.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 1220/2021, të datës 24.12.2021 të parashtruar në KPMSHK; Akt Emërimit të datës 30.09.2011 për ankuesin; shkresën-përgjigje me numër protokoli 2987 të datës 23.11.2021; Kërkesën me numër protokoli 2945 të datës 17.11.2021; kërkesën me numër protokoli 375 të datës 09.03.2020; Përgjigjen

me numër protokoll 592 të datës 23.06.2020; Kërkesën me numër protokoll 1021 të datës 05.06.2020; Akt Emërimit të datës 03.03.2014 për Akt Emërimit të datës 07.08.2012 për Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit të datës 12.02.2015 për Aktvendimin C.Nr. 851/17 të datës 18.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Përgjigje me numër protokoll 2987 të datës 23.11.2021; e- maili i datës 30.06.2021 nga F.K për ankuesin dhe të tjerë fq. 1/6; Autorizimin me numër protokoll 2751 të datës 22.05.2020 për shpalljen e konkursit për pozitën e punës vozitës; Kërkesën me numër protokoll 1038 të datës 16.05.2013; Kërkesën e datës 15.05.2013 për fillimin e procedurës së rekrutimit vozitës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Vozitës; Miratimi i titujve të punës për Ministrinë e Energjisë dhe Minierave e-e-maili i datës 02.07.2021 nga ankuesi për atj. Fq.1/4, e-mail i datës 02.07.2021 nga për ankuesin dhe të tjerë fq. 6; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 38/2022 e datës 10.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit të datës 30.09.2011 është konstatuar se ankuesi është emëruar vozitës, në Sektorin e Logjistikës dhe IT, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik tani Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me koeficient 5 të pagës.

Në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi pretendon se i janë bërë shkelje nga e drejta e punës dhe trajtim jo i barabartë sa i përket koeficientit të pagës në pozitën e tij punë si vozitës, pasi që në ministrinë e tjera vozotësi ka koeficient 6 të pagës.

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 2 paragrafi 6 ku përcaktohet se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*, Kolegji ka konstatuar se pozita e punës vozitës, hyn në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe si rrjedhojë ankuesi nuk e ka statusin e Nëpunësit Civil, kështu që, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.1220/2021 të datës 24.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, udhëzon ankuesin se nëpunësi administrativo-teknik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1220/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit; dhe
- Arkivot të KPMSHCK- së;

